



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Politikave dhe Programeve Ndërkombëtare

KURSE SPECIALIZIMI NGA UNESCO

PËR PLANIFIKIMIN DHE ADMINISTRIMIN ARSIMOR

Instituti Ndërkombëtar për Planifikimin Arsimit (INPA) i UNESCO-s ofron Programin për kurse të specializuara në fushat e planifikimit dhe administrimit të arsimit.

Programi i përgjigjet nevojave të profesionistëve të interesuar për trajnime intensive, afatshkurtra, të specializuara në fusha të veçanta të planifikimit dhe menaxhimit arsimor. Ky program është menduar për punonjës të ministrive të arsimit, të organizatave të tjera qeveritare dhe joqeveritare që punojnë në fushën e arsimit, institucioneve trajnuese dhe universiteteve.

Inkurajohen të aplikojnë veçanërisht kandidatet femra. Data e fundit për dorëzimin dhe paraqitjen e dokumentave është data **31 dhjetor 2013**.

Tarifa e pjesëmarrjes në këto kurse të specializuara është 1800€. Pjesëmarrësit duhet të mbulojnë vetë shpenzimet për transportin ndërkombëtar vajtje-ardhje, për fjetjen dhe qëndrimin në Paris (të cilat llogariten të paktën 100€ në ditë), siguracionin shëndetsor rreth 55€ për një periudhë dyjavore deri në një muaj. INPA nuk ofron bursa për mbulimin e këtyre shpenzimeve dhe inkurajon institucionet kombëtare ta bëjnë këtë gjë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet sponsorizimeve.

Për një informacion më të hollësishëm për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni materialeve informative që gjenden në faqen <http://www.iiep.unesco.org/capacity-development/training/courses-at-iiep/specialized-courses.html>

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE